

Data 14/08/2025.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT : “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete te varfra dhe te pafavorizuara per vitin 2025 ”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):Kodi CPV : Riparim catie

Fondi limit: 47 548 371 (dyzet e shtate milion e peseqind e dyzet e tete mije e treqind e shtatedhete e nje) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës,*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Nuk aplikohet ne kete rast.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike",etj.

3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kërkon:

3.3.1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b.Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 , në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion , tipologjinë e punimeve të ndërtimit etj.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

3.2.Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

1)NP-2 B Ndërtime civile dhe industriale;

2) NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve

3)NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pikat e licences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilën kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Sipas preventivit	B	E kalon vlerën 20 milion leke.
NS-1	Punime për prishjen e ndertimeve	Sipas preventivit	A	Nuk e kalon vlerën 20 milion leke
NS -4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe	Sipas preventivit	B	E kalon vlerën 21 milion leke

	xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese			

3.3. Duke vlerësuar llojin , volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit te punimeve te vendosur nga projektuesi per kete objekt, çdo shoqëri pjesëmarrëse, duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi i një punësim mesatar minimumi prej 44 (dyzet e kater) personave gjithesej (duke perfshire dhe stafin drejtues dhe teknik), për peridhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj - për periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit .

b.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën e kërkuar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perlllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshermerine e realizimit sa me shpejt te objektit. Komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe pergatitjes se dosjes teknike kane analizuar dhe perlllogaritur numrin minimal te punetorise prej 44 punonjesish mesatarisht te dosmosdoshem per realizimin e objektit te prokurimit ne nje afat kohor 80 ditesh- grafik punimesh.

3.4. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të ketë të punësuar staf si drejtues teknik në liçencë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme,**

diploma apo licence profesionale nqs eshte rasti , si dhe të figurojnë dhe në listepagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar me lart , për peridhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit , stafi inxhinierik si më poshtë :

- **Inxhinier ndërtimi 1(nje)**
- **Inxhinier mjedisi 1(nje)**
-

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit

3.5.Duke vlerësuar rëndësinë, llojeshmerine dhe volumi i zerave te punimeve te objektit qe prokurohet, çdo shoqëri pjesmarrëse duhet të dëshmojë që ka në stafin e saj , punonjës te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik (te vlefshme) leshuar nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private te akredituara per verifikimin e punonjesve,me kontrate pune te vlefshme , të domosdoshëm për kryerjen e punimeve :

- 3 (tre) karpentier
- 4 (kater) suvatues
- 4 (kater) shofere për përdorimin e mjeteve
- 2 (dy) hekurkthyes
- 1(nje) teknik ndertimi.

Per manovratorët dhe shoferët e mjeteve te renda duhet te paraqiten dëshmite e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse dhe duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme .

Sqarim: Në rastin kur O.E disponon një punëtor me më shumë se një kualifikim të çertifikuar ky punonjës do të jetë i vlefshëm për të secilin nga kualifikimet që ai disponon.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punëtorinë dhe stafin teknik që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një listë personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, bazuar në përlogaritjen e oreve të punës , kategoritë e punimeve të përcaktuara në preventive, specifikimet teknike të objektit, detajeve të projektit dhe tipologjia e zerave të punimeve , të cilat lidhen ngushtesisht me listën e stafit teknik të kërkuar nga AK , si edhe bazuar në dosmosdoshmerinë e realizimit sa më shpejt të objektit.

3.6. Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim, mjetet e kërkuara janë si vijon:

Nr	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Njesi	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet 1.5-2 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
2	Kamion me kapacitet 10-15 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
3	Kamioncine me kapacitet deri 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	cope	2
4	Kompresor	Në pronësi ose me qira	cope	1
5	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	cope	2
6	Autopompe betoni	Në pronësi ose me qira	cope	2
7	Autovinç	Në pronësi ose me qira	cope	1
8	Vibratore betoni	Në pronësi ose me qira	cope	2
9	Betoniere	Në pronësi ose me qira	cope	3
10	Skela metalike dhe rrjete mbrojtëse për punime në lartësi	Në pronësi ose me qira	M2	700
11	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	cope	1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) , certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.
- e) Per linjen e inerteve ne rast se Operatori Ekonomik i disponon ne pronesi duhet te paraqese aktin e pronesise perkatesisht, ne rast se operatori ekonomik nuk i disponon ne pronesi , duhet te paraqese kontrate qeraje apo kontrate furnizimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “ (perlllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

3.7. Analizat e cmimeve per cdo ze te preventivit te shoqeroje formularin e ofertes ekonomike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i KM nr. 629, date 15.07.2015 „ Per miratimin e manualit teknik te cmimit te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre“ i ndryshuar, VKM nr. 68 date 15.02.2001 „ Per miratimin e standarteve dhe kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit te punimeve te ndertimit „ te perditesuara , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe te paraqesin analizen teknike per cmimet me ane te te cilave do te ofertojne.

3.8.Cdo ofertues duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori. Ne rast BO grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

3.9. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001:2015** (e vlefshme) ose ekuivalente , certifikatën e menaxhimit mjedisor **ISO 14001-2015** (e vlefshme) ose ekuivalente, certifikatën e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë **ISO 45001-2018** (e vlefshme) ose ekuivalente.

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon cdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlefshme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

3.10. Operatori ekonomik Ofertues duhet te dispononje te pakten

- 1 (nje) punonjes pjese e stafit te shoqerise, te certifikuar si ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”, nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- 2 (dy) persona te certifikuar per “Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave”, te cilet duhet te figurojne ne listepagese minimalisht per 3 (tre) muajt e fundit.

- 4 (kater) specialist te certifikuar per "Punime ne lartesi", te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.
- 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine , stafin teknik dhe kerkesat e mesiperme që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

3.11. Operoret ekonomike duhet te deshmojne referuar zerave te preventivit :

Leje / Autorizim per perdorim civil te lendeve plasese te leshuar nga autoritetet shteterore ne nje nga format ligjore ne fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine , stafin teknik dhe kerkesat e mesiperme që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021. **Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe perpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.

Njesia e Prokurimit: